KËRKESË
Nr.3857/1, datë 20.10.2009

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Kalimash-Morinë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm…për interes publik", si dhe në bazë të akteve nënligjore të dala në bazë dhe në zbatim të tij.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Ky publikim bëhet për pasuritë: truall dhe objekte. Vlerësimi i pasurisë truall është bërë në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.872, datë 12.12.2007, ndërsa objektet janë vlerësuar në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.138, datë 23.3.2000.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e këtij shpronësimi është 29 614 986.25 (njëzet e nëntë milionë e gjashtëqind e katërmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë njëzet e pesë) lekë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "KALIMASH-MORINË"

Nr.	Pronari			ZK	Nr. pas	Truall			Objekte Vlera Lekë	Totali Lekë	Vendndodhja	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip. m^2	Çmimi m^2	Vlera lekë				
1	Abedin	Rasim	Oruçi	1543	157/2 157/3	292	2023	590716	25757107	26347823	Lagjja Drinas	Konfirmuar nga ZRPP
2	Habibe	Ahmet	Oruçi	1543	157/4	115	2023	232645		232645	Lagjja Drinas	Konfirmuar nga ZRPP
3	Bashkim	Selman	Cenaj	2315	41/28				306238	306238	Qytet Kukës	Konfirmuar nga ZRPP
4	Vesel	Adem	Dida	1176	297/4				2728280.25	2728280.25	Breg-Lum	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI				**407**		823361	**28791625.25**	29614986.25		Konfirmuar nga ZRPP